



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 587/1 Prot.

Tiranë, më 19.04 2021

V E N D I M

Nr. 42 dt. 19.04. 2021

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË EMËRTIMIN E
DEPARTAMENTEVE TË INSTITUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 30, pika 6, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, në Vendimin e Senatit nr.4, dt.22.01.2021, “Mbi miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2021”, e ndryshuar, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.10, Dt.28.01.2021 “Mbi miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2021”, e ndryshuar, në shkresën e Drejtorit të IKSHS me Nr.549 Prot, dt.08.04.2021 “Propozime për ndryshim emërtimi të Departamenteve të IKSHS”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.04.2021,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në emërtimin e Departamenteve të Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si më poshtë vijon;
 - a) Departamenti i Kërkimit në Veprimtarinë Fizike, Shëndetit dhe Rekreacionit të ndryshojë me emërtimin “**Departamenti i Performancës Sportive**”
 - b) Departamenti i Kërkimit Shkencor të Lëvizjes së Aplikuar, të ndryshojë me emërtimin “**Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit**”
 - c) Departamenti i Kërkimit dhe Studimit të Tregut të Punës dhe të Transferimit të Teknologjisë të ndryshojë me emërtimin “**Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë**”.
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

